

Projekt Marrëveshje e Bashkimit me Përthithje

midis “AgroRoma 2019” SHPK

dhe

“Real Eco Energy” SHPK

Sot, në datën 13/01/2023, në Tiranë, midis shoqërive të mëposhtme:

Shoqëria “AgroRoma 2019” Sh.P.K., shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nuis L91325001D që ushtron aktivitetin e saj tregtar me seli në adresën: Rruga Myslym Shyri, Pallati 1, Tiranë, e përfaqësuar nga administrator z. Soni Agalliu, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J10819107H, madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

(Këtu e në vijim referuar si “AgroRoma 2019” ose, “Shoqëria Përthithëse”)

Dhe

Shoqëria “Real Eco Energy” SH.P.K., shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me Nuis: M11312037A që ushtron aktivitetin e saj tregtar me seli në adresën: dajt, Linze, Tiranë, e përfaqësuar nga administrator z. Edi Agalliu, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal F30821029Q madhor me zotësi të plotë për të vepruar.

(Këtu e në vijim referuar si “Real Eco Energy” ose, “Shoqëria e Përthithur”)

Këtu dhe më poshtë Shoqëria Përthithëse dhe Shoqëria e Përthithur do të referohen bashkërisht si Palët.

1 OBJEKTI

1.1. Objekti i kësaj Marrëveshjeje është bashkimi me përthithje i shoqërisë Real Eco Energy shpk nga shoqëria AgroRoma 2019 shpk sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

1.2. Në zbatim të nenit 220 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Real Eco Energy do të transferojë nëpërmjet bashkimit tërësisht të gjitha aktivet dhe pasivet e saj dhe ekzistenca më vete e real eco Energy shpk do të përfundojë. AgroRoma 2019 do të jetë Shoqëria Përthithëse dhe do të vazhdojë ekzistencën e saj nën emrin e saj të regjistruar dhe tregtar: “AgroRoma 2019” SH.P.K.

2 QËLLIMI I MOTIVUAR

2.1. Shkurtimi i shpenzimeve, përmissimi i pozitës së shoqërisë në treg, menaxhimi më i mirë i aktivitetit ekonomik dhe financiar, rezultat me të mirë në fitimin e shoqërisë.

3 EFEKTIVITETI KONTABËL

3.1. Tërësia e aktiveve dhe pasiveve të Real Eco Energy, të cilat do të transferohen tek Agroroma 2019, do të bazohen në bilancin e audituar të Real Eco Energy dhe AgroRoma 2019 më 31/12/2022 ("Data e Fundit e Kontabilitetit").

3.2. AgroRoma 2019 do të aplikojë opsionin për konsolidimin retrospektiv, prandaj bilanci i hapjes pas bashkimit të AgroRoma 2019 do të paraqitet si rezultat i bashkimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjendjes së pasqyrës së të ardhurave të Real Eco Energy në AgroRoma 2019 duke filluar nga data 01/01/2023 ("Bilanci i Hapjes").

4 VIJUESHMËRIA DHE AKTIVET E TRANSFERUARA

4.1. Në fuqi nga Data e Mbylljes, AgroRoma 2019 do të jetë pasardhësja, nëpërmjet bashkimit me përthithje e Real Eco Energy në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet në të cilat Real Eco Energy është palë, qoftë ekzistuese ose në të ardhmen. Rrjedhimisht, të gjitha aktivet dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha aktivet materiale dhe jo materiale, të gjitha tepricat kreditore, si dhe të gjitha pronat e paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhëniet të tjera juridike dhe pozicione juridike të cfarëdo lloji, të arkëtueshme dhe detyrimet, detyrimet potenciale dhe të ardhurat e ardhshme dhe të kushtëzuara të Real Eco Energy, do të transferohen tek AgroRoma 2019 "Aktivet dhe Pasivet e Transferuara", duke marrë parasysh çdo ndryshim që ndodh deri në datën e mbylljes.

4.2. Aktivet dhe Pasivet e transferuara do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në sa më poshtë vijon:

a. Cdo dhe të gjitha aktivet dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, aktivet materiale dhe jo materiale, pa asnjë kufizim ose përjashtim, të cilat i përkasin ose do t'i përkasin Real Eco Energy;

b. Cdo kredi, borxh, depozitë të cdo lloji të krijuar nga Real Eco Energy;

c. Cdo dhe të gjitha të drejtat që lidhen më ndonjë dhe të gjitha detyrimet e vendosura ndaj Real Eco Energy; e. Cdo kërkesë, mosmarrëveshje, padi dhe procedurë kundrejt cdo Autoriteti ku Real Eco Energy është palë.

4.3. Aktivet dhe pasivet tatimore të Real Eco Energy që rezultojnë në pasqyrat financiare të Real Eco Energy në Datën e Fundit të Kontabilitetit do të transferohen në AgroRoma 2019 njësoj si çdo lloj tjetër i aktiveve dhe pasiveve.

4.4. Nëse pëlqimi i një kreditori ose i një pale të tretë është i nevojshëm për transferimin e aktiveve të caktuara, Real Eco Energy dhe AgroRoma 2019 do të përpiqen, ta sigurojnë atë;

4.5. AgroRoma 2019 do të marrë në zotërim të gjitha librat, korrespondencën, dhe të dhëna të tjera të shoqërisë që ruan dhe mban Real Eco Energy. Agroroma 2019 do të ruaj librat, korrespondencën dhe të dhënat e tjera të shoqërisë Real Eco Energy përgjatë periudhës ligjore të ruajtjes.

5 RAPORTIMI I KËMBIMIT TË KUOTAVE

5.1. Si pasojë e realizimit të procedurës së bashkimit me përthithje të shoqërive në këtë operacion, kapitali themeltar i shoqërisë që rrjedh nga bashkimi me përthithje do të jete ne vleren prej 100.100 lekë dhe do të mbetet në zotërim të ortakut të "AgroRoma 2019", Z. Edi Agalliu qe zoteron 100% te kapitalit ne vlere 100.100 lekë.

6 KUSHTET PËR REALIZIMIN E MBYLLJES

6.1. Përfundimi i transaksionit të Bashkimit të parashikuar në bazë të kësaj Marrëveshje është subjekt dhe kushtëzohet nga plotësimi dhe përmbushja e kushteve të mëposhtme përpara Mbylljes:

a. Vendimi i Ortakëve së të dyja Shoqërive të Bashkuara e miratuar të paktën një muaj pas datës së publikimit të kësaj Projekt Marrëveshjeje të Bashkimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 216.3 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

b. Dhënia e miratimit ose konfirmimit të Bashkimit nga Autoritetet në Shqipëri.

7 MBYLLJA

7.1. Mbyllja do të bëhet në selinë e AgroRoma 2019 në Tiranë sa më shpejt që të jetë e mundur, pas përmbushjes së kushtet paraprake për Mbylljen, ose në cdo datë tjetër ose në cdo vend tjetër ku palët do të dakordësojnë në mënyrë reciproke;

7.2. Në ose përpara datës së Mbylljes, Palët do të realizojnë nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumentave të mëposhtme:

a. Dorëzimin e vendimeve të mbledhjes së ortakëve së agroRoma 2019 dhe Real Eco Energy ku miratohet Mbyllja e Bashkimit, Marrëveshjes së Bashkimit, dhe dokumentet përkatëse dhe/ose çdo dokument tjetër pararendës të kushteve, nëse ka;

b. Shkresat e dorëheqjes dhe/ose revokimit të administratorit (ëve).

7.3. Pas nënshkrimit dhe/ose dorëzimit të dokumenteve të parashikuara në nenin 7.2 më sipër, Palët do të nënshkruajnë Deklaratën e Mbylljes e cila dëshmon përmbushjen e cdo dhe të gjitha kushteve dhe detyrimeve të Palëve për efektivitetin e Bashkimit.

7.4. Bashkimi do të bëhet efektiv në datën e regjistrimit të Bashkimit në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin për Shoqëritë ("Data e Mbylljes").

8 SHOQËRIA, TË DREJTAT DHE PËRFITIMET E VECANTA

8.1. Statuti ekzistues i AgroRoma 2019, i ndryshuar, nëse është e nevojshme dhe i miratuar rregullisht, do të jetë Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

8.2. Anëtarët e organeve të shoqërisë të agroRoma 2019 në Datën e Mbylljes do të jenë anëtarët e organeve të shoqërisë të Shoqërisë Përthithëse. Administratori dhe/ose anëtarët e organeve drejtuese/të përfaqësimit të Real Eco Energy do të japin dorëheqjen dhe/ose do të revokohen në Datën e Mbylljes.

9 MBROJTJA E KREDITORIT

9.1. Kreditorët e Real Eco Energy janë të mbrojtur në zbatim të nenit 221 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

10 PASOJAT PËR PUNONJËSIT

10.1. Shoqëria Real Eco Energy SHPK nuk ka asnjë punonjës, me përjashtim të administratorit të shoqërisë, i cili në Datën e Ekzekutimit do të japë dorëheqjen.

11 ZGJIDHJA E KONTRATËS

11.1. Kjo Marrëveshje do të zgjidhet vetëm në bazë të miratimit me shkrim të të dyja palëve përpara Datës së Mbylljes.

12 LIGJI I ZBATUESHËM

12.1. Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në të gjitha aspektet në përputhje me ligjet dhe cdo dokument tjetër që ka forcën e ligjit në Republikën e Shqipërisë.

12.2. Juridiksioni kompetent do të jetë Gjykata e Rrethit të Tiranës.

13 TË NDRYSHME

13.1. Paraqitja e kërkesave. Palët bien dakord që AgroRoma 2019 dhe Real Eco Energy do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme brenda kompetencave të tyre që duhen për të siguruar dhe garantuar përmbushjen e kushteve të parashtruara më sipër.

13.2. Kostot. AgroRoma 2019 do të paguaj kostot në lidhje me Bashkimin dhe në veçanti kostot që lidhen me Mbylljen dhe përgatitjen e të gjithë dokumentacionit ligjërish të detyrueshëm.

13.3. Pavlefshmëria e pjesshme Nëse një pjesë e kësaj Marrëveshje është ose bëhet e pavlefshme ose jo e detyrueshme për zbatim, Palët janë të detyruara të respektojnë pjesën e mbetura. Palët në

këtë rast do të zëvendësojnë pjesën e pavlefshme ose të jo të detyrueshme për zbatim me dispozita të cilat janë të vlefshme dhe të detyrueshme dhe efekti i të cilave, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj Marrëveshje, është në masën më të madhe të mundshme, e njëjtë me pjesën e pavlefshme ose jo të detyrueshme për zbatim.

13.4. Gjuha dhe Kopjet. Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën Shqipe, në 3 kopje të njëjta.

Shoqëria "AgroRoma 2019" Sh.p.k

Administratori

Soni Agalliu

Soni Agalliu



Shoqëria "Real Eco Energy" Sh.p.k.

Administratori

Edi Agalliu

Edi Agalliu



Raport

Bashkimi me Përthithje i Shoqërive:

AGROROMA 2019 SHPK
si Shoqëri Përthithëse

Dhe

REAL ECO ENERGY SHPK
si Shoqëri e Përthithur

Tiranë, 13/01/2023



1. Deklarata Paraprake dhe Qëllimi i Bashkimit

Në datën **13/01/2023**, me vendim të ortakut të vetëm të AgroRoma 2019 SHPK, u vendos fillimi i procesit të bashkimit me përthithje nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Real Eco Energy (Shoqëria e Përthithur) tek AgroRoma 2019 (Shoqëria Përthithëse). Ky vendim i bashkëngjitet këtij raporti si Aneksi 1A.

Në datën **13/01/2023**, me vendim të ortakut të vetëm të Real Eco Energy SHPK, u vendos fillimi i procesit të bashkimit me përthithje nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Real Eco Energy tek AgroRoma 2019. Ky vendim i bashkëngjitet këtij raporti si Aneksi 1B.

Në përputhje dhe zbatim të vendimeve të mësipërm, Real Eco Energy dhe AgroRoma 2019 do të bashkohen nga ana ligjore dhe organizative. Për këtë qëllim, Real Eco Energy dhe AgroRoma 2019 do të integrohen në një person juridik të vetëm. ("Bashkimi" ose "Bashkimi me Përthithje")

Qëllimi i këtij bashkimi është shkurtimi i shpenzimeve, përmirësimi i pozitës së shoqërisë në treg, menaxhimi më i mirë i aktivitetit ekonomik dhe financiar, rezultat me të mirë në fitimin e shoqërisë.

Perioda nga data e miratimit të projekt marrëveshjes së bashkimit (nënshkrimit të projekt marrëveshjes së bashkimit) deri në datën e regjistrimit të transaksionit të Bashkimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të jetë një periudhë tranzitore gjatë së cilës Real Eco Energy dhe AgroRoma 2019 do të marrin një sërë masash e do të plotësojnë disa kushte me qëllim përbushjen me sukses të Bashkimit me përthithje.


2. Forma Ligjore e Bashkimit dhe Përshkrimi i Procedurës së Bashkimit

Bashkimi i shoqërive me përthithje nënkupton transferimin e të gjithave aktiveve dhe pasiveve nga Shoqëria e Përthithur tek Shoqëria Përthithëse. Real Eco Energy si Shoqëria e Përthithur dhe AgroRoma 2019 si Shoqëria Përthithëse do të bashkohen përmes procedurës së Bashkimit me Përthithje.

Procedura për realizimin e bashkimit me përthithje duhet të kalojë nëpërmjet dy fazave shumë të rëndësishme procedurale, të cilat njoftohen dhe regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Faza e parë fillon me hartimin e një projekt marrëveshje nga përfaqësuesit ligjorë të dy shoqërive. Kjo projekt marrëveshje i bashkëngjitet këtij raporti si Aneksi 2. Projekt marrëveshja midis palëve duhet të përmbajë të paktën informacionet e parashikuara në nenin 216 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Projekt marrëveshja është një kontratë, e cila përmban termat përfundimtar që u propozohen për nënshkrim ortakëve të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim. Duke qenë që gjuha teknike e përdorur në projekt marrëveshje mund të jetë e vështirë për tu kuptuar lehtësisht, ligji detyron përfaqësuesit ligjor që të hartojnë këtë raport me qëllim që projekt marrëveshja të kuptohet lehtësisht nga ortakët. Projekt marrëveshja duhet të depozitohet të paktën 1 muaj para datës së caktuar për mbledhjen e



asamblesë së shoqërive pjesë e bashkimit që do të miratojnë projekt marrëveshjen e bashkimit. E gjitha kjo bëhet me qëllim që ortakët të njihen me projekt marrëveshjen si dhe me impaktin e saj.

Publikimi duhet të përfshijë këto dokumenta:

1. Projekt marrëveshjen;
2. Raportin e hollësishëm të përfaqësuesve ligjorë mbi projekt marrëveshjen;
3. Pasqyrat financiare dhe ato të ecures së veprimtarisë së shoqërive për të paktën tre vitet e fundit;

Faza e dytë është ajo e miratimit të projekt marrëveshjes së bashkimit në asambletë e shoqërive në proces bashkimi.

Pas miratimit të projekt marrëveshjes, njoftohen organet tatimore dhe të gjitha autoritetet përkatëse të cilat duhet të autorizojnë bashkimin.

Përfaqësuesit ligjorë, pas marrjes së autorizimit dhe kryerjes së njoftimit në autoritetet përkatëse, si dhe miratimit përfundimtar të projekt marrëveshjes së Bashkimit dhe këtij raport të Bashkimit nga asambletë përkatëse të shoqërive, do të njoftojnë bashkimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Vetëm pas këtij njoftimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit mund të vijohet me:

1. Transferimi tek shoqëria përthithëse e të gjitha aseteve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur;
2. Ç'regjistrimin e shoqërisë së përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit (pas regjistrimit të vendimit të asambleve në Qendrën Kombëtare të Biznesit, shoqëria e përthithur konsiderohet e prishur).

Kreditorët e Shoqërisë së Përthithur kanë të drejtë që brenda 6 muajsh nga publikimi i vendimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit të paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve dhe të kërkojnë garanci të mjaftueshme nga shoqëria përthithëse për kreditë e tyre. Ligji konsideron garanci të mjaftueshme lëshimin e një deklarate me shkrim nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, ku pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyrë të vecuar deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithë kreditorëve.

3. Struktura e Shoqërive të Përfshira në Bashkim

Në datën e këtij raporti, Real Eco Energy është 100% në pronësi të Z. Edi Agalliu si ortak i vetëm i zotërues i kuotave. Ky fakt lehtëson dhe përshpejton procesin e vendimarrjes lidhur me bashkimin me përthithje të shoqërive. Kapitali themeltar i shoqërisë që rrjedh nga bashkimi me përthithje do të jete në vlerën prej 100.100 lekë dhe do të mbetet në zotërim të ortakut të "AgroRoma 2019" Z. Igli Tare që zoteron 100% të kapitalit në vlerë 100.100 lekë.

4. Bilancet në Mbyllje dhe Bilanci i Celjes së Bashkimit me Përthithje

Bashkimi me përthithje do të bazohet në pasqyrat financiare të Real Eco Energy dhe AgroRoma 2019 të datës **31/12/2022** (Data e Fundit Kontabël).

Data e Ekzekutimit të Bashkimit do të jetë data e regjistrimit të bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Bilanci i Celjes së Shoqërive Përthithëse do të bazohet në bilancin e konsoliduar të datës së Fundit Kontabël të të dy shoqërive përpara përthithjes dhe fillon në datën **01/01/2023**. Cdo ndryshim, saktësim dhe korrigjim i mundshëm i Bilancit të Celjes, realizuar mes Datës së Fundit Kontabël dhe Datës së Ekzekutimit të Bashkimit me Përthithje duhet te raportohet dhe miratohet përkatësisht nga asambltetë e ortakëve të të dy shoqërive.

5. Aktivet dhe Pasivet e Transferueshme

Ne bazë të nenit 215, pika 1 e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, të gjitha aktivet dhe pasivet e Shoqërisë së Përthithur Real Eco Energy sipas Bilancit të Datës së Fundit Kontabël, do të transferohen tek shoqëria përthithëse AgroRoma 2019. Aktivet dhe pasivet e transferuara janë ato që do të jenë të përcaktuara në Bilancin Kontabël të Datës **31/12/2022** si dhe cdo ndryshim i ndodhur në librat kontabël nga Data e Fundit Kontabël deri në Datën e Ekzekutimit të Bashkimit me Përthithje.

Aktivët dhe detyrimet tatimore të Real Eco Energy sic rezultojnë në pasqyrat financiare së datës së fundit kontabël, do t’i transferohen AgroRoma 2019 së bashku me të gjithë llojet e tjera të aktiveve dhe detyrimeve.

Me transferimin e aktiveve dhe të detyrimeve, AgroRoma 2019 do të marrë në posedim të gjithë evidencat, librat kontabël, korrespondencat, regjistrimet, marrëveshjet dhe dokumenta të tjera të cilat provojnë ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve që transformohen. Me transferimin e aktiveve dhe pasiveve, shoqëria do të gëzojë të drejtat për të ngritur pretendime ligjore për këto aktive si dhe do të ketë detyrimin për tu përgjigjur ndaj pretendimeve që mund të ngrenë palë të drejta ndaj shoqërisë së përthithur.

6. Efektet mbi Punëmarrësit

Shoqëria Real Eco Energy SHPK nuk ka asnjë punonjës, me përjashtim të administratorit të shoqërisë, i cili në Datën e Ekzekutimit do të japë dorëheqjen.

7. Efektet mbi Organet Drejtuese të Shoqërise Përthithëse pas Përthithjes.

Bashkimi me përthithje nuk do të sjellë asnjë ndryshim në organet drejtuese të Shoqërisë Përthithëse. Në Datën e Ekzekutimit administratori i shoqërisë së përthithur do të japë dorëheqjen.

8. Efektet Ligjore të Bashkimit

Në përputhje me parashikimet në nenin 220, pika 3, e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, regjistrimi i bashkimit të shoqërive pjesë e bashkimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sjell si pasojë:

a) ka pasojë kalimin të shoqëria përthithëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që përthithet. Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe të palët e treta;

b) bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pa kaluar në procesin e likuidimit.

Vetëm Shoqëria Përthithëse AgroRoma 2019 do të vazhdojë të ketë personalitet juridik.

Bashkimi nuk do të ketë efektë të tjera lidhur me kapitalin e shoqërisë përthithëse duke qënë se kjo e fundit zotëron 100% të kuotave në Shoqërinë e Përthithur. Për këtë arsye nuk është I nevojshëm raporti i këmbimit të kuotave.

9. Lista e Anekseve

Aneksi 1A – Vendim i Ortakut të Vetëm të shoqërisë AgroRoma 2019 për autorizimin e fillimit të procedurës së bashkimit me përthithje.

Aneksi 1B – Vendim i Ortakut të Vetëm të shoqërisë Real Eco Energy për autorizimin e fillimit të procedurës së bashkimit me përthithje.

Aneksi 2 – Projekt Marrëveshja e Bashkimit.

Ky raport përgatitet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse në bashkim, në gjuhën shqipe.

Real Eco Energy SHPK

Përfaqësuar nga:

Edi Agalliu

Administrator

Edi Agalliu



AgroRoma 2019 SHPK

Përfaqësuar nga:

Soni Agalliu

Administrator

